



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

Nr. 17909 Prot.

Lezhë, më 5.11.2024

URDHËR

Nr. 585, Datë 5.11. 2024

“PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË KONSULTIMEVE PUBLIKE PËR  
TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE (PAKETA FISKALE 2025) NË BASHKINË  
LEZHË”

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” i ndryshuar, Ligjit Nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, Vendimin Nr.393 datë 18.07.2022 “Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Lezhë” si dhe Vendimin Nr.43, data 13.02.2024 “Për miratimin e Kalendarit të Konsultimeve Publike për vitin 2024 në Bashkinë Lezhë”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e kalendarit të konsultimeve publike për Taksat dhe Tarifat Vendore në Bashkinë Lezhë (Paketa Fiskale 2025).
2. Konsultimet do të realizohen sipas kalendarit bashkëngjitur, në koordinim me Këshillin e Bashkisë Lezhë.
3. Të ngarkohet Drejtoria e Projekteve Strategjike, Evropës, Emigracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës për koordinimin e procesit të konsultimit lidhur informimit rreth takimeve, publikimin e dokumentacionit dhe transparencën me publikun.
4. Të ngarkohet Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për mbajtjen e procesverbaleve e listëprezencave të takimeve si drejtori përgjegjëse për hartimin e projekt-aktit.
5. Seciles drejtori të sipërcituar t’i përcillet nga nje kopje e udhërit si dhe Këshillit të Bashkisë Lezhë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Pjerin NDREU

